

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrestohet Eno Agasi: Dyshohet për zhdukjen e verës me vlerë miliona euro
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392092.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:21:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	16 shtator 2026, 17:08:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 16 shtator 2026, 17:07:00 UTC → 16 shtator 2026, 17:09:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4973f6a77a7d36940218114c2e6e8316ec434a72c4fe26d96159d221c3d38bd8
TEKSTI	f84d32ca23ff0694720454a340be5094622390c417badc2766d711bd47879ca2
PAMJA	f6117a62d52d5d04e1e37232faaf70ea4e07c3f88bbf17fa2535f271aff42524

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	54b46880a807644c628029ba4ab26e26c9f5f9da44bf19ba3ba98b1a710a7d11
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/54b46880a807644c628029ba4ab26e26c9f5f9da44bf19ba3ba98b1a710a7d11>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Arrestohet Eno Agasi: Dyshohet për zhdukjen e verës me vlerë miliona euro

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 16.09.2026, 19:08



Share



Share



Policia e Shtetit ka ekzekutuar ditën e sotme urdhërarrestin për Eno Agasin, i cili ishte shpallur në kërkim nga Prokuroria e Tiranës pas hetimeve të nisura për zhdukjen e një sasive të konsiderueshme vere nga kantina në pronësi të kushëririt të tij, Ergys Agasi.

Sipas të dhënave paraprake nga grupi hetimor, ngjarja ka marrë udhë pasi është kryer inventarizimi i mallit në kantinë. Sasia e verës, e cila kap vlerën e miliona eurove, ishte lënë përkohësisht në magazinë sepse procedurat doganore nuk lejonin transportimin e saj gjatë orëve të natës. Megjithatë, kur përgjegjësit janë rikthyer mëngjesin e ardhshëm për të kryer tërheqjen e mallit, kanë konstatuar se e gjithë sasia e verës mungonte.

Dyshimet kryesore të hetuesve bien mbi Eno Agasin si i përfshirë drejtpërdrejt në largimin e kësaj sasive të madhe verë. Situata rëndohet edhe më tej nga faktet e grumbulluara, sipas të cilave janë fshirë edhe pamjet e kamerave të sigurisë në ambientet e kantinës, një veprim ky i kryer me synim pengimin e zbardhjes së ngjarjes dhe fshehjen e provave.

Ndaj të arrestuarit tashmë rëndojnë disa akuza penale, ku përfshihen kontrabanda me mallra që paguajnë akcizë, magazinimi i mallrave që paguajnë akcizë, si dhe kryerja e veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës.

Çështja po ndiqet nga prokurori Bledar Valikaj. Ndërsa pjesa e dosjes që lidhet me Ergys Agasin i është referuar më parë për kompetencë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, hetimet për kushëririn e tij po vijnë të kryhen pranë Prokurorisë së Tiranës.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat



Alliance për
Media
Ethics

ARTIKULL JOETIK?

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.